

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“JUAR INDUSTRIES“ shpk

Date 01 / 09 / 2023

ORTAKET THEMELUES

Ferdinant Dapi, i biri i Kudretit, lindur me 14/12/1979, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjofimin me numer H91214001K, me date leshimi 20/10/2021, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe

Elvis LLeshi, i biri i Aleksandrit, lindur me 19/07/1994, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me Pashaport me numer J40719040T, me date leshimi 11/11/2021, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personat e mesiperm, jane Ortaket e Shoqerise si me poshte".

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar **“JUAR INDUSTRIES“ shpk**

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne adresen: Lagja 15, Rr.Aleksander Goga,Nr.pasurie 2/513/ND, Z.Kad. nr.8511, Spitali , Durres.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Shoqeria **“JUAR INDUSTRIES“ shpk** gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Objekti i veprimtarise i shoqerise **“JUAR INDUSTRIES“ shpk** eshte:

1-Aktivitet ne fushen e prodhimit te materjaleve te ndertimit, nxirrjes, shfrytezimit dhe perpunimit te burimeve minerale, mermereve, graniteve etj

2-Tregetimin e materjaleve te ndertimit te prodhuara nga shfrytezimi, perpunimi dhe prodhimi I burimeve minerale, mermereve, graniteve etj.

3-Importim dhe Eksportim e produkteve industrial te materjaleve te ndertimit, graniteve, mermereve etj, me shumice e pakice.

4-Eksport te materjaleve prej druri, nenprodukteve prej druri.

5-Grumbullim perpunim per Eksport te bimeve medicinal.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Durres.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne Ortaket e Shoqerise.

Ortaket themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortaket.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 100.000 Leke (njeqind Mije Leke) e ndare ne 2 kuota, 1 me vlere nominale 51.000 leke kuota, dhe 1 me vlere nomonale 49.000 leke kuota.

Kuotat jane te ndare ne kete menyre:

- | | |
|-------------------|-----|
| 1. Ferdinant Dapi | 51% |
| 2. Elvis Lleshi | 49% |

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Neni 11

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Neni 12

Administrator i shoqerise "**Ferdinant Dapi**" shpk do te jete: ADMINISTRATOR

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 5 vjetesh financiare. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njej . Administratori ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 13

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Asambleja e Ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Neni 14

Asambleja e Ortakeve emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te filialeve te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakeve, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 15

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e shoqerise percaktohen ne statutin e saj.

ORTAKET E SHOQERISE

"JUAR INDUSTRIES" shpk

Ferdinant Dapi

Elvis Lleshi

S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“JUAR INDUSTRIES” Shpk

Date 01 / 09 / 2023

KREU I-re

Dispozita te Pergjitheshme

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “JUAR INDUSTRIES“ shpk eshte themeluar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkuar nga Ortaket:

Ferdinant Dapi, i biri i Kudretit, lindur me 14/12/1979, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftimin me numer H91214001K, me date leshimi 20/10/2021, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe

Elvis LLeshi, i biri i Aleksandrit, lindur me 19/07/1994, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me Pashaport me numer J40719040T, me date leshimi 11/11/2021, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare'dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007'Per Qendren Kombetare te Biznesit' dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personat e mesiperm jane Ortaket e Shoqerise si me poshte:

Neni 1.

Emertimi i shoqerise eshte “JUAR INDUSTRIES“ shpk Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

Ajo rregullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria “JUAR INDUSTRIES“ shpk eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet: “JUAR INDUSTRIES“ shpk.

Neni 2.

Objekti i veprimtarise i shoqerise "JUAR INDUSTRIES" shpk eshte:

1-Aktivitet ne fushen e prodhimit te materjaleve te ndertimit, nxierrjes, shfrytezimit dhe perpunimit te burimeve minerale, mermereve, graniteve etj

2-Tregetimin e materjaleve te ndertimit te prodhuara nga shfrytezimi, perpunimi dhe prodhimi I burimeve minerale, mermereve, graniteve etj.

3-Importim dhe Eksportim e produkteve industrial te materjaleve te ndertimit, graniteve, mermereve etj, me shumice e pakice.

4-Eksport te materjaleve prej druri, nenprodukteve prej druri.

5-Grumbullim perpunim per Eksport te bimeve medicinal

Neni 3.

Shoqeria ka Seline e saj ne adresen: Lagja 15, Rr.Aleksander Goga, Nr.pasurise 2/513/ND,ZK Nr.8511 ,Spitall, Durres.

Ajo mund te çele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 4.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

KREU II-te

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve

Neni 5.

Ortakët gezojnë keto të drejta kryesore:

- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne aktin e themelimit dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
- Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tyre ose nga ata vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

- Te bej propozime dhe t'i paraqes ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeroje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Neni 6.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuotat suplementare ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin.
- Te marr pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
- Te kryej detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

KREU III-te

Kushtet Ekonomike

Neni 7.

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni 8.

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i Regjistruar miratohen nga Ortaket. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 9.

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

Neni 10.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 100.000 Leke (njqind Mije Leke) e ndare ne 2 kuota me vlere nominale, 1 kuote 51.000 leke dhe 1 kuote 49000 leke.

Kuotat janë të ndara në këto mënyra:

- | | |
|--------------------------|-----|
| 1. Ferdinant Dapi | 51% |
| 2. Elvis Lleshi | 49% |

Neni 11.

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e marë Ortaket. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregtare etj, përfitohen prej Ortakeve të kësaj shoqërie plus interesat si rezultat i investimit të tyre. Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rruge trashëgimie. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohet me akt noterial. Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmone në përputhje me qëllimin e objektin e veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Neni 12.

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 13.

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së luajtshme e të palujtshme, sipas afatëve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kredite për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndet e para apo ndihmese e energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takojnë ortakeve themelues të saj.

KREU IV-te

Neni 14

Asambleja e Ortakeve merr vendime për çdo aspekt të veprimtarisë së shoqërisë

Kompetencat ekzekutive të tij janë:

1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshimet në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
3. Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.
4. Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që perkufizojnë raportet me gjirin e shoqërisë, duke përfshirë edhe kuadrin e personelit.
5. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
6. Përcaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese.
7. Emerimi dhe zëvendësimi i Administratorit të përgjithshëm të shoqërisë.
8. Krijimi i organeve të tjera të domoshëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.

9. Percaktimi i madhesise se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
10. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
11. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
12. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
13. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
14. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likuidimit te cilet emrohen dhe revokohen prej tij.
15. Marrjen e vendimit per marje huaje, kredi, venie si garanci hipotekore.

Neni 15

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga administratori i saj i Pergjithshem.

Administratori emerohet **Ferdinant Dapi** per nje kohezgjatje prej 5 vjetesh.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:

-Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme si dhe administron pasurine e shoqerise .

-Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.

-Raporton dhe i pergjigjet Ortakeve per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.

-Siguron drejtimin e shoqerise.

-Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne domosdoshmerisht vendimin e Asamblese se Ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakeve.

-Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.

Neni 16.

Mardheniet e punes ne shoqeri.

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Mbi kete baze shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU V-te
Mbyllja e Shoqerise:

Neni 17.

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortaku heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet e pakufizuar.

Neni 18.

Kur shoqeria likujdohet:

Asambleja e Ortakeve emeron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij raporti te hartuar.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakeve, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 19.

Kjo Shoqeri mund te riorganizohet nepermjet bashkimit me nje shoqeri tjeter, nepermjet ndarjes ne dy apo ne shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderimit te formes Ligjore.

Shoqeria mund te riorganizohet pasi ka qene e regjistruar per te pakten nje vit.

Bashkimi i Shoqerive kryhet ne perputhje me dispozitat per mbrojtjen e konkurences.

Neni 20.

Per cdo pike qe nuk parashikohet ne kete statut do ti referohemi Ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKET E SHOQERISE

"JUAR INDUSTRIES" shpk

Ferdinant Dapi



Elvis Lleshi

